



# Buletin Informativ

## Prill 2020

SHOQATA KOMBËTARE E GRAVE PROFESIONISTE, AFARISTE E ZEJTARE TË SHQIPËRISË

NË KËTË NUMËR

### COVID i mallkuar, por edhe i bekuar!

Nga Flutura Xhabija

Virusi arriti aq shpejt sa nuk ishim përgatitur aq, por...kur ke lidhje e bashkëpunime me veten, me familjen, me miqtë e bashkëpunëtorët, me partnerët dhe anëtarët e shoqatës tënde, sigurisht e merr veten menjëherë dhe hyn në forcë. Menjëherë u riorganizova, do të bëj të përditshmen, por diçka më tepër, ato punë që nuk mund t'i bëja kur isha në zyrë. Po si të ndaj kohën, edhe kësaj i dhashë drejtim, pasiviteti në shtëpi, gatim, ndjekje lajmesh dhe lexim. Po me shoqatën me kohë krijova grupet e qyteteve on line; u lidhëm shpejt sapo hyri ndalimi shtëpiak për të gjithë dhe filluam informacionin; megjithatë menjëherë krijova grupin e rrjetit kombëtar; për katër ditë punova fort të ribëj lista me telefona, numra të humbur e të gjetur, harresë anëtarëshe etj; dhe ja u bëmë 62 veta, tani çdo ditë i dërgoj informacionin zyrtar, shtetëror, kolektiv, etj; anëtarët pothuaj mbi 50 përqind janë aktive, po integrohen me rrjetin;

janë bërë 3 video-call, me Tiranën, Shkodrën dhe Durrësin, Pogradecin dhe Lezhën.

Përtej kësaj u lidha on line menjëherë me kryetarin e Dhomës së Tregtisë së Tiranës, kryetarin Nikolin Jaka dhe bordi filloi të funksionojë e po funksionon, japim mendime, kërkesa, alternativa dhe i përcillen qeverisë, parlamentit, policisë; kjo e fundit menjëherë u përfshi në informacionet e reja për rregullat e qarkullimit edhe të sipërmarrësve, ndërsa Ministria e Financave dhe Ekonomisë na informon për vendimet e reja në ndihmë të biznesit: për lehtësimin e tij në kreditime, pagesa punonjësish, qarkullimin e nevojshëm të disa drejtuesve të biznesit, shtyrjen e sigurimeve shoqërore, pagesave etj. Përsëri kemi plane dhe i përgatisim çdo ditë, së bashku si grup...asnjëherë nuk jemi vetëm, nuk jemi pa ide dhe pa sugjerime të duhura në dobi të biznesit të stopuar, të cunguar e me një mijë probleme funksionimi. **Megjithatë do ia dalim!**

### Konkluzione të vrojtimit mbi njohjen e programeve të BE-së / kombëtare për sipërmarrjen nga të rinjtë

Në numrat e mëparshëm të buletinit ju kemi informuar se SHGPAZ në kuadër të zbatimit të... **F.2**



### Paketat ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor ndaj COVID-19

Masat që kanë marrë qeveritë në Ballkanin Perëndimor në kohën e COVID-19: Mbështetje për bizneset, kujdesin shëndetësor dhe qytetarët... **F.8**



## Konkluzione të vrojtimit mbi njohjen e programeve të BE-së / kombëtare për sipërmarrjen nga të rinjtë

Nga Tefta Demeti

Në numrat e mëparshëm të buletinit ju kemi informuar se SHGPAZ në kuadër të zbatimit të projektit "Nxitja e Sipërmarrjes dhe të Mësuarit mbi Sipërmarrjen tek të Rinjtë dhe Gratë në Shqipëri", të financuar nga BE-ja nëpërmjet CFCU pranë MFE, zhvilloi gjatë vitit 2019 një vrojtim me rreth 309 të rinj në disa Universitete dhe Shkolla të Mesme në 9 rrethe të ndryshme të Shqipërisë si në: Tiranë, Durrës, Lezhë, Shkodër, Pukë, Fushë-Arrëz, Pogradec, Fier dhe Vlorë. Në këtë shkrim po ju njohim me konkluzionet e këtij vrojtimi si më poshtë:

- 1. Programet e BE-së** për mbështetjen e të rinjve **njihet pak** nga ata, prandaj ka nevojë për përmirësimin e vizibilitetit të këtyre programeve në mediat elektronike dhe sociale, promovimin e mëtejshëm të këtyre programeve, shpërndarjen e informacioneve nëpërmjet rrjeteve të të rinjve, përmirësimin e metodave informuese.
- Programi i BE-së **që njihet më pak** nga të rinjtë ishte programi **Marie Skłodowska-Curie (MSC)**, i cili u dedikohet kërkuesve dhe inovatorëve të rinj dhe informacionet për këtë janë të pakta, aplikimet nga Shqipëria edhe më të pakta dhe përfitimet pothuaj të papërfillshme.

- 3. Programet kombëtare** për mbështetjen e të rinjve edhe pse janë të pakta **njihet edhe më pak** se ato të BE-së nga të rinjtë, ndërsa përfitimet janë shumë të pakta. Fondet lokale për të rinjtë pothuaj mungojnë. Vetëm Bashkia Tiranë ka disa programe dedikuar të rinjve.
- Në kushtet e njohjes së paketë nga të rinjtë të programeve mbështetëse, edhe **grantet e përfituara prej tyre janë të pakta** në numër duke konfirmuar kështu nevojën për një prezantim më të mirë të tyre për të rritur më shumë grupin e përfituesve nga këto grante.

- Vrojtimi, edhe pse kishte një numër të kufizuar stafi pedagogjik, tregoi se **mësuesit/ pedagogët e përfshirë nuk shfaqën njohuri më të mira se ato të nxënësve** apo studentëve të tyre. Duke nënvizuar kështu se krahas punës me të rinjtë, një tjetër shtyllë e rëndësishme në shpërndarjen e informacionit është edhe nëpërmjet shpërndarjes së njohurive për programet mbështetëse tek profesorët dhe mësuesit.
- Rezultatet e këtij pyetësori tregojnë se **numri i të rinjve** shqiptarë që zotërojnë një biznes të tyre apo kanë të afërm që **zotërojnë një biznes** familjar është **i ulët**, duke nënvizuar se ka akoma shumë hapësira për të përmirësuar iniciativat e sipërmarrjes private midis të rinjve.
- Rezultatet e këtij vrojtimi në secilën nga pyetjet konfirmojnë **dominin gjinor të vajzave për marrjen e njohurive**, duke nënvizuar rolin aktiv që gruaja ka edhe në këtë drejtim, një avantazh i cili duhet të jetë në vëmendjen e autoriteteve dhe në adresimin e krijimit të programeve mbështetëse gjinore.



# 10 Aftësitë “hard” më të kërkuara nga kompanitë

Përkthyer dhe përshtatur nga Ana Zacharian<sup>1</sup>

Përgjatë vitit 2020 kompanitë do të kenë më shumë nevojë për **aftësitë “hard”** të tilla si:

## # 1 Blockchain - E Re

Blockchain lindi në 2009 për të mbështetur përdorimin e “valutës së koduar” (cryptocurrency). Por mënyra e re e blockchain për ruajtjen, vërtetimin, autorizimin dhe lëvizjen e të dhënave nëpër internet ka evoluar duke ruajtur dhe dërguar në mënyrë të sigurt çdo aset digjital. Ka kërkesa të mëdha për numrin e vogël të profesionistëve që kanë këtë aftësi.

## # 2 Cloud Computing –1 vend më poshtë

Sot, ndërmarrjet ndërtohen dhe drejtohen në “re”. Ata kanë nevojë

Personat që mund të përdorin fuqinë e IA-së, mësimin e makinerive dhe përpunimin e natyrshëm të gjuhës janë ata që do të ndihmojnë kompanitë të ofrojnë produkte dhe shërbime më të rëndësishme, të personalizuar dhe inovative.

## # 5 Dizajni “Eksperienca e përdoruesit” - Njësoj si 2019

Duket se kohëzgjatja mesatare e vëmendjes së konsumatorëve zvogëlohet çdo vit dhe ata kanë pak durim për produkte që nuk janë intuitivë. Organizatat kanë nevojë për më shumë ekspertizë për t'i ndihmuar ata të ndërtojnë më shumë produkte dhe përvoja që kanë në qendër njeriun.

individë me shumë influencë ndaj një audience të caktuar.

## # 8 Shitjet - Njësoj si 2019

Kompanitë kanë nevojë për njerëz me aftësi të shkëlqyera në shitje - ata që mund të menaxhojnë në mënyrë efektive një ekip shitjeje, të kuptojnë kanalet e shitjeve, të punojnë me partnerë ndër-funksionalë dhe të shesin në nivelet më të larta të biznesit.

## # 9 Informatika shkencore – 3 vende më poshtë

Këtë aftësi e kanë profesionistët e të dhënave shkencore, inxhinierët, arkitektët e software-ve etj. Kompanitë kanë nevojë për më shumë profesionistë që mund të zhvillojnë modele makinash mësimi dhe të aplikojnë qasje statistikore dhe analitike në grupe të mëdha të dhënash duke përdorur programe si Python, MATLAB etj.

## # 10 Prodhimi i videove - 3 vende më poshtë

Konsumatorët kanë një oreks të madh për përmbajtjet e videove, kështu që është e kuptueshme që kjo aftësi vazhdon të shihet me përparësi nga kompanitë. Cisco vlerëson se videot do të përbëjnë 82% të trafikut global të internetit në 2022.

Shpresojmë që me këto informacione mbi nevojat që kanë sot kompanitë, ndihmojmë në fuqizimin e individëve me aftësi kyçe për të patur sukses në karrierën e tyre.

<sup>1</sup>Presidente e AlbanianSkills, Eksperte në Arsimit dhe Formim Profesional



për talente të cilët kanë aftësi për t'i ndihmuar ata të drejtojnë arkitekturën teknike, hartimin dhe shpërndarjen e sistemeve “re” si Microsoft Azure.

## # 3 Arsyetimi Analitik - Njësoj si 2019

Të dhënat janë bërë themeli i çdo biznesi. Organizatat duan talente që e kuptojnë dhe e përdorin këtë gjë dhe që kanë njohuri të nxisin vendimet më të mira për biznesin.

## # 4 Inteligjenca artificiale - 2 vende më poshtë. Rrit aftësitë e fuqisë punëtore njerëzore.

## # 6 Analiza e biznesit – 10 më lart

Analiza e biznesit bëri kërcimin më domethënës të çdo aftësie në listën tonë. Është një nga aftësitë e pakta “hard” që çdo profesionist duhet të ketë, pasi shumica e roleve kërkojnë njëfarë niveli të analizës së biznesit për të marrë vendime.

## # 7 Marketingu “Affiliate” - E Re

Me rënien e reklamave tradicionale dhe rritjen e mediave sociale, marketingu “affiliate” po rritet me shpejtësi si një aftësi e domosdoshme. Ky lloj marketingu synon partneritet me kompani apo

## Një kartëmonedhë si homazh mjekes tuniziane në kohën e COVID 19

**Nga Flutura Xhabija**

Më datën 8 Prill 2020, tek "Le Monde d'Afrique", në Tunizi, gazetarja Lilia Blaise boton një shkrim tërheqës, jo feminist, as ndonjë çudi e madhe, por në sintoni me situatën e pandemisë, me situatën luftarake të barazisë gjinore, në situatën e kreativitetit, në situatën e mirë/keq-qeverisjes dhe në situatën e rivlerësimit të vlerave humane, të grave dhe të mjekëve.

Portreti i Tawhida Ben Cheikh zbukuronte kartmonedhën e re 10-dinarëshe (rreth 3 euro, ose 40 lekë) duke u shfaqur në mes të krizës së koronavirusit. Më pëlqeu shumë si vlerësim, si gjetje adapte për gjendjen botërore dhe për gruan. Madje, e ndjeva edhe si një inkurajim për të gjitha vendet që të vlerësojnë të diturin, aktivistin, kontribuesin, dal vivo apo post mortum, si modele për ecje përpara, e jo për dekorata apo kartona (me tonelata tek Ne, sidomos), që shumë pak frymëzojnë brezat e rinj!

Mendova t'jua kaloj edhe ju çfarë perceptova, ashtu modestisht, dhe... shqipëro, e shto mendime (e drejta e autorit) po jua përcjell sa më qartë që të mundem. Që nga data 27 Mars 2020, fytyra e saj do të mbetet e pavdekshme, në atë kartëmonedhë tuniziane. Edhe këtu ka një historizë të vogël, por të rëndësishme: ky vendim shtetëror, për të nderuar këtë zonjë është diskutuar, përgjatë dy viteve, dmth botimi i kësaj kartmonedhe 10-dinarëshe, u emetua në mes të krizës shëndetësore të koronavirusit si një simbol i fortë, "...për t'i bërë homazh personelit mjekësor që ndodhet në vijën e parë të kësaj krize, (me emrin e bukur vdekjeprurës virus me kurorë), Covid-19", deklaroi guvernatori i Bankës Qendrore të Tunizisë.

Për disa prej nesh, emër i padëgjuar, edhe pse kam mjaft gra intelektuale dhe miq të mirë nga Tunizia. Prandaj

gjeta shpejt e shpejt se kush është Tawhida Ben Cheikh: gruaja e parë muslimane që ka ushtruar profesionin e mjekut në Magreb, e para tuniziane që ka marrë diplomë (në vitin 1928).

Ajo u lind në vitin 1909, dhe rrugëtimi i saj shpesh ka marrë karakterin e një romani epik në historinë bashkëkohore të Tunizisë. Siç dihet Tunizia ka qenë deri vonë nën protektoratin francez; nëna e saj, një e ve e re, që e rriti me katër vëllezërit dhe motrat e saj, e dërgoi me shumë sakrificë e në luftë me mentalitetet fetare dhe patriarkale, për të studiuar mjekësi në Paris, nën mbrojtjen e bakteriologut francez Etienne Burnet, drejtor i Institutit Pasteur në Tunizi.

Kështu e filloi Tawhida karrierën e saj si mjekë, pediatre dhe gjinekologe. Në vitet '30, pas studimeve në Paris, pediatrja e re u kthye në vend dhe hapi zyrën e saj pranë Medinës në Tunis. Ajo nuk mund të praktikonte në spitalin publik që atëherë ishte bastion i mjekëve francezë. Populli filloi ta mbiquajë "mjekja e të varfërve" sepse ushtronte profesionin në një lagje shumë të populluar dhe pacientët e saj jetonin në kushte të vështira. Në atë kohë, gratë shpesh e kërkonin për të asistuar lindjet në shtëpi, pra u bë edhe një obstetër dhe më pas gjinekologe. Në vitin 1943, Tawhida u martua me një dentist, me të cilin pati dy djem dhe një vajzë. Me daljen në pension, ajo i kushtohet familjes së saj, duke marrë përsipër edhe asistencën për lindjen e shtatë nipërve dhe mbesave të saj.

Si çdo profesioniste e vërtetë, aktiviste dhe me devocion, sigurisht i mungonte shpesh familjes sepse luftonte në të gjitha frontet, qoftë për jetimët a njerëzit që humbën shtëpitë e tyre gjatë bombardimeve të luftës së dytë botërore; ajo gjithashtu luftoi për qasje në kujdesin shëndetësor për



të gjymtuarit dhe për të drejtën e abortit (legalizuar në 1973). Vajza e saj tregon se në fëmijëri, e ka parë mjaft rrallë mamanë e vet, në shtëpi, nënën e saj humaniste, të cilës edhe ajo tashmë i ngjan për këtë veti; e ëma shquhej për një forcë të jashtëzakonshme, dëshironte të ndihmonte gruan tuniziane të çlirohej nga të gjitha barrat e saj; ajo hapi një klinikë private në vitin 1963 në Montfleury, një lagje e Tunis, kryeqyteti i Tunizisë, dhe ndihmoi në krijimin e Planifikimit Familjar, duke u emëruar shpejt edhe si drejtoreshë në institucionin shtetëror Tawhida Ben Cheikh vdiq në 6 dhjetor 2010 në moshën 101 vjeç. Gjatë jetës së saj, edhe pse i hapi rrugën një gjenerate të tërë, ku sot, pothuajse gjysma e mjekëve në Tunizi janë gra, ishte shumë pak e vlerësuar; nderimet e ndoqën pas vdekjes si psh. një qendër shëndetësore me emrin e saj, u inagurua në vitin 2011 në Montreuil, një bashki periferike pariziane dhe një pullë postare u emetua me figurën e saj Post Tuniziane, në vitin 2012. Këtu nuk mbaron historia; kartmonedha është një punë kolektive, tregon stilisti dhe dizenjatori i saj, mori formën e saj së pari nga një nga fotot e saj të albumit familjar. Kështu kjo kartmonedhë fringo, është gjithashtu një homazh kolektiv edhe ndaj aktorëve të tjerë të daljes së saj - shpesh të padukshëm - në historinë bashkëkohore të Tunizisë.

## Pronësia Intelektuale: Historia e Djathit francez “Roquefort”

Nga Albana Laknori

**Territori ku prodhohet: Francë.**

Në fillim bëhej fjalë për një zonë të gjerë të jugut të Francës në Masivin Qendror, i cili, siç parashikohet nga ligji i 26 Korrikut 1925, paraqiste të njëjtat karakteristika në profilin e rracave të dhenve, kullotave dhe klimës dhe karakterizohej nga një pamje e egër dhe e thatë, në të cilin kullotnin kopetë e deleve. Falë përpjekjeve të punonjësve profesionistë të Roquefort për të inkurajuar rritjen e gjedhëve, për të zhvilluar prodhimin e qumështit dhe për të rritur lidhjen midis produktit dhe mjedisit gjeografik, qumështi i përdorur për prodhimin e djathit Roquefort vjen ekskluzivisht nga zona e quajtur “Rayon”, e cila përmbledh 560 komuna, ose pjesë të komunave, që futen në rajonet e Aveyron, Aude, Lozère, Hérault, Gard e Tarn.

**ORIGJINA:** Qumësht deleje

**FORMA DHE PËRMASAT:** Formë cilindrike me anë të sheshta me diametër 19-20 cm, zhveshje të drejtë, gjatësi 8.5-11,5cm. Peshë 2,5-3 kg.

**HISTORIA:** Në depozitat parahistorike të rajonit, është e mundur të vihen re flluska djathi. Që prej shekullit të VIII, djathi Roquefort është cituar në shumë shkrime, akte dhurimi dhe të ardhurash të provincës Rouergue. Në shekullin XV, Carlo VI e njehej me

dokument patentën e shpikjes, të konfirmuar nga pasardhësit, për



nevojën e mbrojtjes së djathit Roquefort. Me 31 Gusht 1666, me një dekret të Parlamentit të Tuluzës, i jepet ekskluziviteti i stazhionimit banorëve të Roquefort sur Soulzon. Kështu Roquefort është edhe djathi i vetëm, i cili njihet me ligj si emërtim gjeografik i mirënjohur, që prej vitit 1925. Prodhimi i tij në fakt ndjek metoda që kanë ndryshuar me kalimin e kohës.

**LLOJI I DJATHIT SIPAS LLOJIT TË PUNIMIT:** Pastë e butë

**TEKNOLOGJIA E PUNIMIT:** Qumështi duhet të punohet brenda 48 orëve nga mjelja, në temperaturë 28-34 gradë celsius. Shtimi e peneciliumit të djathi Roquefort bëhet në formë të lëngshme në momentin e shtesës së mullëzës, ose duke e shpërndarë në momentin e zënies së gjizës. Kjo arrihet duke shtuar qumësht me mullëz. Kur mbaron koagulimi, bëhet si rrotë

dhe tundet. Pas spastrimit dhe kriposjes, djathërat transferohen në shpella.

**MATURIMI/STAZHIONIMI:**

Minimumi 90 ditë. Në shpellat e Roquefort sur Soulzon, që ndodhen në shpatet e malit Combalou, është vendi ku është i detyruar stazhionimi.

**KARAKTERISTIKAT E**

**DJATHIT:** Korja është e butë, pasta e djathit është vajore, kompakte, me damarë, me ngjyrë fildishi, me myk ngjyrë bojë qielli.

**TIPOLOGJIA E DJATHIT PER KONSUM:** Djathë vajor, stazhionim i mesëm, me pastë me damarë.

**INTENSITETI AROMATIK DHE NDJESHMËRIA:** Lehtësisht e mesme.

**KOMBINIMI ME VERËRAT:** Verë Sauter, verëra të kuqe të ëmbla.



## Eurobarometer: Shqiptarët janë të kujdeshëm për vlerat ushqyese!

Një sondazh *Eurobarometer* i dalë rishtazi tregon se shqiptarët janë më të interesuar për vlerat ushqyese të produkteve që ata konsumojnë në krahasim me konsumatorët në Bashkimin Evropian, por shqiptarët tregojnë një interes më të ulët në sigurinë ushqimore se sa qytetarët e BE-së. Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore (EFSA) ka botuar gjetjet e *Eurobarometer* bazuar në një pyetësor për sjelljet e konsumatorëve, duke përfshirë edhe perceptimin rreth ndërgjegjësimit dhe rrezikut në lidhje me sigurinë ushqimore. Pyetësori u zhvillua në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, si edhe në pesë vende të para-anëtarësimit, duke përfshirë Shqipërinë.

Në Shqipëri u zhvilluan 1046 intervista në total gjatë nëntorit 2019. Pyetësori u nda në dy pjesë: pjesa e parë tregon interesin e qytetarëve për sigurinë ushqimore dhe tjetra paraqet ndërgjegjshmërinë dhe perceptimin e rrezikut.

Rezultatet tregojnë se 18% e qytetarëve shqiptarë të pyetur tregojnë interes personal në temën e sigurisë ushqimore në krahasim me 41% të qytetarëve të BE-së.

Rezultatet tregojnë gjithashtu se përbërja e vlerave ushqyese (sasia e vitaminave, proteinave, sheqernave dhe yndyrnave) është fakti me peshën më të rëndësishme për

konsumatorët shqiptarë (63 përqind e tyre), të ndjekur nga rreziqet e sigurisë ushqimore në lidhje me disa ushqime të caktuara (58 përqind e tyre). Ndërkohë që për qytetarët e BE-së dëftuesit më të rëndësishëm kur blejnë ushqime janë prejardhja e ushqimit (58%) dhe kostoja (51%).

Burimet mediatike si televizionet, gazetat dhe revistat konsiderohen burimet kryesore të informacionit si për qytetarët e BE-së (69%) ashtu dhe të Shqipërisë (61%).

Në krahasim me 22% të qytetarëve të BE-së të sonduar, 48% e qytetarëve shqiptarë e shohin sigurinë si shqetësimin kryesor kur zgjedhin ushqimin.

Rezultatet e sondazhit tregojnë gjithashtu se kur bëhet fjalë për perceptimin e substancave të rrezikshme në ushqim, 46 përqind e qytetarëve shqiptarë bëjnë kujdes me prodhimet që kanë lëndë të rrezikshme, që është në të njëjtën linjë me perceptimin e qytetarëve të BE-së (43%).

Në Shqipëri, duket se ka një mungesë informacioni për tema të caktuara siç janë lëndët shtesë (krahaso Shqipërinë - 38% me BE - 72%), higjenën e ushqimit (Shqipëria - 19 %; BE - 68%), mbetjet e pesticideve tek ushqimi (Shqipëria - 30%; BE- 65%), reaksione alergjike nga ushqimet dhe pijet (Shqipëria - 9%; BE- 65%) dhe sëmundjet e kafshëve (Shqipëri - 19%; BE- 65%),

krahasuar me informacionin e gjendur për qytetarët e BE-së.

Mbetjet e antibiotikëve, hormoneve dhe steroideve tek mishi janë temat më shqetësuese për qytetarët e BE-së (44%), ndërkohë që qytetarët shqiptarë shfaqin shqetësim për organizmat e modifikuar gjenetikiisht (OMGJ) në ushqim (41%) dhe lëndëve shtesë si ngjyrat, konservuesit apo aromatizuesit në ushqim apo pije (34%).

Kur shtrohet pyetja se sa besim kanë qytetarët shqiptarë në burime të caktuara të informacionit, pjesëmarrësit në sondazh dëshmuar se kanë besim në informacionin e botuar nga institucionet e BE-së për rreziqet e ushqimeve (me 79%), ndërkaj 56% thanë se kanë besim në informacionin e autoriteteve vendase.

Hollësitë e plota të pyetësorit gjenden në anglisht në *link-un* vijues:

[http://www.efsa.europa.eu/sites/default/files/corporate\\_publication\\_s/files/eurobarometer19/country-factsheets/eb\\_s\\_92.3\\_fact\\_al\\_en.pdf](http://www.efsa.europa.eu/sites/default/files/corporate_publication_s/files/eurobarometer19/country-factsheets/eb_s_92.3_fact_al_en.pdf)

THE  
FOOD  
SAFETY  
PROJECT

## FAKTE

25.7%

**Biznese aktive të drejtuar/ pronare gra, për vitin 2018 në Shqipëri rezultojnë 25.7% me një ulje ↘ prej 4 pikë % krahasuar me 2017 (29.7%). (INSTAT, qershor 2019)**



7.5%

**Kredia për vitin 2019 rezulton me një rritje të ndjeshme prej 7,5% krahasuar me një vit më parë dhe zë 36,5% ndaj PPB, por përsëri më e ulët me 1 pikë përqindje krahasuar me 2016. (Banka e Shqipërisë, shkurt 2020)**



## Çfarë kanë të përbashkët vendet me përgjigjet më të mira ndaj koronavirusit?

### Udhëheqëse gra!

Po kërkonit shembuj të Leadershit të vërtetë në një krizë? Nga Islanda në Tajvan dhe nga Gjermania në Zelandën e Re, gratë po i tregojnë botës se si të menaxhojnë një situatë të paprecedent për familjen tonë njerëzore. Shtoni Finlandën, Islandën dhe Danimarkën, dhe kjo pandemi është duke zbuluar që gratë kanë atë që duhet kur nxeh-tësia rritet në Shtëpitë e Qeverisjes. Shumë do të thonë se këto janë vende të vogla, ose ishuj, ose përrjashtime të tjera. Por Gjermania është e madhe dhe po udhëheq, dhe Mbretëria e

Bashkuar është një ishull me rezultate shumë të ndryshme. Këto udhëheqëse po na dhurojnë një mënyrë alternative dhe tërheqëse për të ushtuar pushtetin.




## Sa shpenzojnë vendet në sistemet e tyre shëndetësore?

Një nga aspektet më shqetësuese të kësaj pandemie është mënyra në të cilën ai ka paralizuar dhe mposhtur disa prej sistemeve më të mira shëndetësore në botë. Raporti i fundit i OECD "Shëndeti në një vështrim" tregon sa para kanë shpenzuar çdo vit për sistemin shëndetësor vendet që janë prekur më shumë nga COVID-19. Të dhënat tregojnë se Sh.B.A shpenzon më shumë nga çdo vend i OECD - ekuivalent me 16.9 përqind të PBB-së ose mbi 10,000 dollarë për person. Italia Veriore vlerësohet të ketë një nga sistemet më të mira dhe më efikase shëndetësore në botë, por ajo kaloi shpejt në kolaps nga vala e COVID-19, veçanërisht për shkak të mbingarkesës së kapaciteteve të Njësisë së Kujdesit Intensiv dhe mungesës së ventilatorëve. Shpenzimet shëndetësore të Italisë janë

ekuivalente me 8.8% të PBB-së dhe Spanja e ngjashme me 8.9%. Koreja e Jugut përsëri e ngjashme në 8.1%, megjithëse ka shmangur plotësisht fatin e Italisë dhe Spanjës duke lëvizur me shpejtësi për të provuar, gjurmuar dhe izoluar rastet e konfirmuara COVID-19. Që nga 1 Prilli i vitit 2020, ajo kish-te vetëm 165 vdekje ndërsa pandemia ishte kryesisht e stabilizuar. [www.statista.com](http://www.statista.com)

### How Much Do Countries Spend On Their Health Systems?

Health expenditure as a percentage of GDP in 2018



Source: OECD



statista

# Paketat ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor ndaj COVID-19

Nga Kujtime Stefani

- ✓ **Shqipëria: (deri 14.04.2020)** •Një paketë prej 340 mln eurosh si mbështetje financiare për bizneset, kujdesin shëndetësor dhe një-rëzit në risk, përfshirë garancinë sovranë për kredinë e bankave tregtare për kompanitë që kanë vështirësi për të paguar pagat e punëtorëve, mbështetje financiare për mikro bizneset dhe të vetpunësuarit, dhe fshirja e gjobave për pagesa të vonuara të faturave të energjisë, për më shumë se 200 mijë njerëz; •Pezullimi i katër kontratave PPP dhe procedurat e prokurimit publik; •Rritja e buxhetit për familjet që marrin ndihmë ekonomike; •Mbështetje për pagat e punonjësve 93 mln Euro; •Mbështetje për të vetpunësuarit, të papunët dhe përfitimet -13 mln Euro; •Shlyerje e vonuar e kredive për ata që aplikojnë -3 muaj; •BSH uli normën e politikës në 0.5%
- ✓ **Bosnje–Herzegovina: deri 8.4.20** •Në FBiH, Fondi i Stabilizimit, 225 milion EUR për të mbuluar kontributet për pagat minimale të punonjësve; •Fonde shtesë për kantone dhe bashkitë në FBiH; përjashtimi nga tarifatat para-fiskale për bizneset e prekura; •Anullohet pagesa e taksës mbi të ardhurat e korporatave •Në Republikën Serbske(RS), shtyhet pagesa e taksës mbi të ardhurat e korporatave; marzhi fiks i çmimeve për disa produkte kryesore; qeveria mbulon pagat minimale, taksat mbi të ardhurat dhe kontributet për bizneset e prekura. •Banka e zhvillimit në RS ka shtyrë pagesat e vonuara.
- ✓ **Kosova: (deri 14.04.2020)** •Qeveria ka aprovuar një paketë ndihme emergjente për të mbështetur sektorët e prekur, për të rritur shpenzimet shëndetësore dhe për të ndihmuar shtresat në nevojë; •Banka Qëndrore e Kosovës lëshoi një moratorium për shlyerjen e huasë për huamarrësit në vështirësi deri në 30 Prill, për t'u vendosur rast pas rasti nga huadhënësi. Paketa e ndihmës emergjente 179,6 milion EUR; •Mbështetje për pagat e punonjësve (faza e parë, 2 muaj) Paga minimale prej 170 EUR plus kontribute pensioni.
- ✓ **Mali i Zi: (deri 06.04.2020)** •Shtyrja e taksës mbi pagat dhe e kontributeve shoqërore; •Kredi e butë nga Fondi Shtetëror i Zhvillimit të Investimeve (IRF), në ndihmë të kompanive të prekura deri në 3 milion EUR (për 2-vjet me 1.5% normë interesi); •Huadhënësit janë ndaluar nga banka qendrore të paguajnë dividend për aksionerët; •Për punonjësit e kujdesit shëndetësor COVID-19 pagat në mars rriten deri në 15%; •Zgjatja e afateve për pagesën e qirasë në pronat shtetërore dhe e shlyerjes së kredive deri në 90 ditë. Mbështetja e qeverisë për shtresat në nevojë, total 1 mln Euro (50 Euro për person).
- ✓ **Maqedonia e Veriut: (deri 14.04.2020)** •Qeveria do paguajë pagat minimale të punëtorëve në ndërmarrjet e prekura nga koronavirusi, në prill dhe maj dhe do subvencionojë 50% të kontributeve sociale për punëtorët; •Firmat përjashtohen nga paradhëniet e taksave të korporatave në prill-qershor; •Banka e Zhvillimit e Maqedonisë së Veriut (BZHVMV) zgjeron dhënien e kredive të buta (me normë 1.5% interesi) përmes bankave tregtare dhe kredive pa interes (3000-9000 Euro) për kompani, pagesa pas 6 muajsh dhe periudha e shlyerjes 2 vjet; •Zgjatja e periudhës kohore për të klasifikuar një kredi si NPL, nga 90 në 150 ditë, deri në fund të shtatorit; •Procedura më të shpejta dhe të drejtpërdrejta për ndryshimin e kushteve të marrëveshjeve të kredisë; •Kompensimi i pagesës për punëtorët e larguar nga puna; •Kredi nga BZHVMV për NMV-50 mln Euro (kredi e butë); 12 mln Euro (kredi pa interes).

<https://www.ebrd.com/>



## COVID-19: Testet Serologjike

Materiale të përpunuara nga Arlinda Demeti

Testet serologjike zbulojnë antitrupa të pranishëm në gjak, që janë proteina specifike (imunoglobulina) që prodhohen si përgjigje ndaj infeksioneve, si COVID-19. Me fjalë të tjera, testi zbulon reagimin imunitar të trupit ndaj infeksionit të shkaktuar nga virusi sesa zbulon vet virusin. Antitruapat e zbuluar nga ky test tregojnë se një person ka një përgjigje imune ndaj SARS-CoV-2, pavarësisht nëse simptomat ishin shfaqur apo infeksioni ishte asimptomatik. Rezultatet e testit të antitruapave janë të rëndësishme në zbulimin e infeksioneve me pak ose aspak simptoma. Në ditët e para të një infeksioni kur përgjigjja imune e trupit akoma po ndërtohet, antitruapat mund të mos zbulohen. Kjo kufizon efektivitetin e testit për dhe për këtë arsye nuk duhet të përdoret si test i vetëm për të diagnostikuar COVID-19.

Aktualisht testet serologjike të autorizuara për SARS-CoV-2 masin antitruapat IgM dhe/ose IgG. Meqenëse antitruapat IgM mund të mos zhvillohen herët ose mund të mos zhvillohen fare në pacientët e infektuar, prandaj ky lloj testi nuk përdoret për të përjashtuar infeksonin me SARS-CoV-2 te një individ. Meqenëse antitruapat IgG në përgjithësi zhvillohen më vonë, ky lloj testi, edhe pse është më specifik për SARS-CoV-2, nuk përdoret për të përjashtuar infeksonin me SARS-CoV-2 në një individ. Ne gjithashtu nuk e dimë se sa kohë antitruapat IgM ose IgG

ndaj SARS-CoV-2 qëndrojnë në trup pasi të jetë larguar infeksioni.

Ndërkohë që testet e antitruapave në vetvete kanë një vlerë të kufizuar në diagnostikimin e menjëhershëm të një pacienti ku dyshohet për infektion COVID-19, përdorimi i këtij lloji testi te shumë pacientë mund të ndihmojë komunitetin mjekësor të kuptojë më mirë sesi zhvillohet reagimi imunitar ndaj virusit SARS-CoV-2 tek pacientët me kalimin e kohës dhe sa njerëz mund të jenë infektuar. Në një kohë që ka shumë pasiguri me këtë virus të ri, është gjithashtu e mundur që, me kalimin e kohës, përdorimi i gjerë i testeve të antitruapave dhe ndjekja klinike do t'i ofrojë komunitetit mjekësor më shumë informacione nëse dhe për sa kohë një person i cili është rikuperuar nga virusi ka rrezik më të ulët të ri-infeksionimit nëse ai ekspozohet përsëri ndaj virusit.

Testet serologjike mund të luajnë një rol kritik në luftën kundër COVID-19 duke ndihmuar profesionistët e kujdesit shëndetësor të identifikojnë individët që e kanë kaluar infeksonin dhe kanë zhvilluar një përgjigje imunitare. Në të ardhmen, kjo mund të përdoret potencialisht për të ndihmuar në përcaktimin, së bashku me të dhënat e tjera klinike, që individët të tillë nuk janë më të ndjeshëm ndaj infeksionit dhe mund të



kthehen në punë. Për më tepër, këto rezultate të testit mund të ndihmojnë në përcaktimin se kush mund të dhurojë një pjesë të gjakut të tyre të quajtur "plazma konvanshente", e cila mund të shërbejë si një trajtim i mundshëm për ata që janë të sëmurë rëndë nga COVID-19.

**FDA** (Food and Drug Administration) rekomandon ofruesit e kujdesit shëndetësor:

- Vazhdoni të përdorni testet serologjike (antitruapa), sipas rastit, dhe të jeni të vetëdijshëm për kufizimet e tyre.
- Mos përdorni testet serologjike si bazë e vetme për të diagnostikuar COVID-19, por si informacion në lidhje me faktin nëse një person mund të jetë ekspozuar.
- Jini të vetëdijshëm që jo të gjitha testet serologjike në treg janë vlerësuar nga FDA. Testet e autorizuara të FDA-së, përfshirë testet serologjike, janë renditur në faqen e Autorizimeve të Përdorimit në Emergjencë (EUA).

<https://www.fda.gov/medical-devices/letters-health-care-providers/important-information-use-serological-antibody-tests-covid-19-letter-health-care-providers>

## KONSULENCË LIGJORE PËR PRONËSINË INTELEKTUALE: MARKAT TREGTARE, PATENTAT E SHPIKJEVE, E DREJTA E AUTORIT, ETJ.

Ofrojmë mbrojtje, konsulence tekniko-shkencore dhe ligjore, si për personat fizike, si për bizneset që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj:

### Në fushën e Pronësisë Intelektuale:

-Zgjidhje të problemeve tuaja në lidhje me:

#### ➤ **Markat tregtare dhe të shërbimit, logot tregtare**

-Konsulencë në hartimin e logos së biznesit tuaj.

-Konsulencë në krijimin e logos tuaj të re.

-Kërkim për marka ndërkombëtare.

-Si të aplikojmë për marka të Madridit.

-Si të bëjmë një kontratë license market e huaj

#### ➤ **Patentat e shpikjeve**

#### ➤ **Konsulencë në formulimin e një patente shpikjeje**

-Si të mbrojmë atë që kemi krijuar apo shpikur.

-Si të aplikojmë për një patente shpikjeje evropiane.

-Si të aplikojmë për një patente PCT (në EİPO), Zvicër.

-Si të sjellim në Shqipëri patentat e huaja?

#### ➤ **Modelet e përdorimit**

-Çfarë është një model përdorimi?

-Si të dallojmë një patentë shpikjeje nga një model përdorimi.

-Si të mbrojmë një model përdorimi.

#### ➤ **Emërtimet gjeografike**

-Çfarë është një emërtim gjeografik?

-Si të bashkangjijmë një emërtim gjeografik produktin.

#### ➤ **Dizenjot industriale**

-Çfarë është një dizeno industrial?

-Sa dimesnione (përmasa) ka një dizeno.

-Si mund të mbrohet një dizeno.

#### ➤ **Të drejtën e Autorit**

-Kuptimi i Copyright (të Drejtës së Autorit)

-Si mund të mbrojmë një produkt artistik të ri.

-Si mund të përdorim një produkt artistik të ri duke respektuar të drejtën e autorit.

**Mbrojmë të Drejtat e Pronësisë Intelektuale në të gjitha Gjykatat e të gjitha niveleve**

-Në ju përfaqësojmë në Bordin e Apelit të Drejtorisë së Patentave dhe Markave.

-Ju përfaqësojmë në Dhomën e Arbitrazhit pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë.

-Në Gjykatën e Faktit Tiranë, të Apelit / Administrative.

-Në Gjykatën e Lartë.

#### ➤ **Konsulencë të specializuar për shpikjet në Unversitetet publike dhe private**

-Në fushën e legjislacionit të IP.

-Në fushën e ligjeve ndërkombëtare të IP.

-Në fushën e patentave të shpikjeve, markave tregtare.

-Si të kthejmë një diplomë në një aset të Pronës Intelektuale.

-Si mund të përshtaten në këto asete në një biznes.

Na kontaktoni në çdo kohë në:

**PhD Candidate. Albana Lankori**

**mobile+355 693410000**

**E-mail: [albanalankori@gmail.com](mailto:albanalankori@gmail.com)**

*Shënim: Opinonet e paraqitura në buletin janë ato të vetë ekspertëve dhe nuk paraqesin opinionin e BE-së*

**Buletin  
Informativ**

Prill 2020



**Përgatitur nga:**

**Msc. Flutura XHABIJA &  
Msc., MA Arlinda DEMETI  
&Redaksia**